



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:096090

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06231934

Ac.nr.2413/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore me paditësve E.D., H.D. dhe S.D., që të gjithë nga fshati V., ..., Komuna e Pejës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson O.L., avokat nga Peja, kundër të paditurit B.P., nga fshati V., ..., Komuna e Pejës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.G., avokat nga Peja, me bazë juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e palës paditëse, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.988/16 të datës 18.12.2020, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 11.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësve E.D., H.D. dhe S.D., që të gjithë nga fshati V., ..., Komuna e Pejës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.988/16 i datës 18.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.988/16 të datës 18.12.2020, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve E.D., H.D. dhe S.D., nga fsh. V., ..., K. Pejë, me të cilën kanë kërkuar që të: vërtetohet se janë pronarë në pjesët e ngastrave kadastrale dhe atë: pjesën e parcelës me nr. të njësisë ..., në sipërfaqe prej 131 m², në anën veriore (kah parcela ...) në gjatësi prej 110.67 me nga pika e detajit 3,4 deri në 5; -në anën jugore (kufiri kadastral në mes palëve) në gjatësi prej 110.74 m, nga pika e detajit C deri në B; -në anën lindore (ka parcela ...) në gjatësi prej 1.28 m nga pika e detajit 3 deri në B dhe në anën perëndimore (kah rruga publike ...) në gjatësi prej 1.71m nga pika e detajit 5 deri në C. Pjesën juglindore te parcelës me nr. të njësisë ... në sipërfaqe prej 201 m², në anën veriore (kah vet parcela ...) në gjatësi prej 159.96m, nga pika e detajit 1,2 deri në 3, në gjatësi prej 94.89 m (nga pika 1 deri në 2; -në anën jugore (kufiri kadastral në mes palëve) në gjatësi prej 158.84 m, nga pika A deri në B; -në anën lindore (kah parcela ...) në gjerësi prej 1.06 m, nga pika e detajit 1 deri në A; dhe –në anën perëndimore (kah parcela nr...) në gjatësi prej 1.28 m, nga pika e detajit 3 deri në B, ashtu që të detyrohet i padituri B.P. nga fsh. V., ..., që paditësve

tua pranoj të drejtën e pronësisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe e njëjta të regjistrohet pranë Zyrës Komonale Kadastrale në Pejë, si pronë e paditësve, si dhe tua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 2587.80 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi e nënë kërcënim të përmbartimit me dhunë. Në pikën II, refuzohet propozimi i paditësve E.D., H.D. dhe S.D., me të cilën kanë kërkuar që të caktohet masa e sigurisë ndaj të paditurit B.P., ashtu që ti ndalohet që të punoj në megjen e ngastrave kadastrale nr... dhe ... ZK. V. deri në përfundim të këtij kontesti me vendim të formës së prerë. Në pikën III, detyrohen paditësit E.D., H.D. dhe S.D. që solidarisht të paditurit B.P. t'ia paguajnë shumën prej 1.890,00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuari i paditësve brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar i autorizuari i të paditurit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe vlerësimit të thënieve ankimore, gjeti se:

Ankesa e paditësve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 04.11.2016, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, kundër të paditurit, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 30.09.2019, duke kërkuar që të miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësve, të vërtetohet se të njëjtit janë pronarë të pjesët e ngastrave kadastrale të cekura si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar. I padituri në shqyrtim kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që e njëjta të hedhet si e pabazuar.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadiës së precizuar të paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.988/16, të datës 18.12.2020, me të cilin e ka refuzuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësit nuk kanë arritur që ta argumentojnë legjitimitetin aktiv për të qenë palë në procedurë pasi që me asnjë provë nuk e kanë argumentuar se nga buron e drejta e pronësisë në patundshmërinë që është objekt i këtij kontesti, siç është e drejta e trashëgimisë, mbajtja, puna juridike etj., dhe se të njëjtit nuk kanë arritur që ta argumentojnë me prova siç është dëshmia e vdekjes së trashëgimtarë të kujt janë nga i cili do të buronte e drejta e pronësisë, pasi që me të paditurin nuk kanë asnjë raport

juridik të vlefshëm. Me rastin e daljes së gjykatës në vend shikim është vërtetuar fakti se kjo patundshmëri që është objekt i kontestit është në posedim të të paditurit, i cili këtë patundshmëri e kishte blerë një pjesë në vitin 1988 ndërsa pjesën tjetër në vitin 2016 nga M.P., M.P. dhe I.P. Tutje gjykata ka arsyetuar se të njëjtit nuk kanë asnjë të drejtë në pjesën kontestuese të ngastrave të të paditurit këtë gjykata e ka vërtetuar edhe me rastin e daljes në vend shikim ku shihej qartë se mexha faktike (mexha natyrore e përbërë nga drunj të bagrenit) ishte mexhë e vjetër e cila e ndante pushtetin faktik në mes të palëve ndërgjyqëse, kjo mexhë faktike ishte pothuajse identike edhe me vijën kadastrale në mes të ngastrave ..., ..., (ngastra të të paditurit) dhe ngastrave kadastrale numër ..., ..., ... dhe ... (në posedim të paditësve dhe pronësi të D.D.). Lidhur me mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar nenit 322.1, 2 lidhur me nenin 7 dhe 297 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Po ashtu, ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera ligjore të pretenduara nga pala ankuese në ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) i LPK-së për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi i atakuar është hartuar konform kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 160 të LPK-së, sepse nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, duke arsyetuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësve sipas të cilave gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Kjo pasi gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike sipas propozimit të palës paditëse ka bërë marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarëve, palëve ndërgjyqëse, dhe me këqyrje në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë ku eksperti sipas detyrave të dhëna nga gjykata ka bërë matjen e pjesës së parcelës ..., dhe ..., të cilat janë në pronësi të të paditurit, e për të cilat paditësit pretendojnë se nga mexha faktike natyrore në gjerësi një metër në brendi të tyre i takon e drejta e pronësisë, dhe bazuar në këto matje eksperti i gjeodezisë Shkëmb Kastrati, në ekspertizën e datës 05.08.2019, ka konstatuar se sipërfaqja të cilët paditësit pretendojnë se e mbajnë në

posedim është 131 m², në pjesën jugore të ngastrës ..., dhe 201 m², në pjesën jug-lindore të ngastrës ..., duke paraqitur edhe dimenzionet e shtrirjes siç është pasqyruar në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjykata me rastin e daljes në vend shikim ka vërtetuar faktin së mexha faktike (mexha natyrore e përbërë nga drunj të bagrenit) ishte mexhë e vjetër e cila e ndante pushtetin faktik në mes të palëve ndërgjyqëse, dhe së kjo mexhë faktike ishte pothuajse identike edhe me vijën kadastrale në mes të ngastrave ..., ..., të cilat janë në pronësi të të paditurit dhe ngastrave kadastrale numër ..., ..., ... dhe ..., të cilat janë në posedim të paditësve dhe pronësi të D.D..

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, duke marrë parasysh faktin së paditësit kanë pretenduar së e kanë fituar të drejtën e pronësisë në pjesën e ngastrave që janë në pronësi të të paditurit në bazë posedimit më mirëbesim. Në bazë të nenit 20 par.1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gazeta zyrtare e RSFJ nr.6/80), është paraparë së *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.”* Kurse për sa i përket mënyrës së fitimit të pronësisë me parashkrim fitues, neni 28 par. 2 përcakton: *“Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.”* Kurse par.3 i të njëjtit nen përcakton së *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”*. Lidhur me fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, gjithashtu ligji pasues, ai për Pronësisë dhe të Drejtat e Tjera Sendore nr.03/L-154, përkatësisht me nenin 40 par. 1 parashikon se *“Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të”*. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit vlerëson se fitimi i të drejtës së pronësisë me parashkrimi fitues në vetvete duhet të përmbaj katër elemente të cilat duhet të plotësohen në mënyrë komulative dhe se pa plotësimin e qoftë vetëm njërit nga këto kushte, parashkrimi fitues nuk mund të jetë bazë për fitimin e pronësisë në paluajtshmëri siç janë: 1 mbajtësi i ligjshëm, 2 mirëbesimi, 3 kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe 4 posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Gjykata e Apelit, pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë së në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë, pasi që paditësit nuk kanë mundur ta provojnë faktin se të njëjtit janë posedues të pjesës kontestuese të patundshmërisë që nga viti 1962 e deri me tani nga paraardhësi i tyre juridik tani i ndjeri Islam Kapllan Daci. Kjo për faktin se me rastin e daljes së gjykatës në vend shikim është vërtetuar fakti se kjo patundshmëri që është objekt i kontestit është në posedim të të paditurit B.P. i cili këtë patundshmëri e kishte blerë një pjesë në vitin 1988 ndërsa pjesën tjetër në vitin 2016 nga M.P., M.P. dhe I.P.. Për me tepër, edhe përmes dëgjimit të dëshmitarëve nuk ka mundur të vërtetohet fakti së paditësit e kanë mbajtur në posedim dhe janë sjellë si pronar në pjesën kontestuese përtej kufirit faktik-natyorë që është pothuajse identik me kufirin kadastral, pasi që edhe dëshmitari I.L., që ka deklaruar së me parë ka qenë vija për ujitje përtej kufirit kadastral e cila ka kaluar nëpër ngastrat e të paditurit përskaaj bagremëve, ka deklaruar së këtë vijë e ka shfrytëzuar edhe familja e paditësve edhe familja e të paditurit, pasi që të gjithë kanë marrë ujin për ujitje nga aty, dhe kur ka punuar të paraardhësit e paditësve kanë kositur në atë kohë nga bagrenat e teposhtë, ndërsa bagrenat kanë qenë mexhë. Në këtë kontekst, posedimi konsiderohet se është me

mirëbesim, po që se mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në rastin konkret rezulton se paditësit kanë qenë në njohuri lidhur me mexhën (vijën kufizuese në mes të palëve), e cila është mexhë e vjetër, është pothuajse identike me mexhën kadastrale, e gjithë kjo duke u bazuar në ekspertizën e gjeodezisë. Prandaj, Gjykata e Apelit, pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë së është i pabazuar pretendimi i paditësve se kanë të drejtën e pronësisë përtej kufirit faktik (bagrenave të shoqëruar edhe me tel xhemborë) e cila është pothuajse identike me mexhën kadastrale bazuar në ekspertizën e gjeodezisë, pasi që fakti së për skaj saj ka qenë vija e ujitjes së tokave nuk nënkupton se të njëjtit e kanë të drejtën e pronësisë mbi atë pjesë të patundshmërisë. Kjo sepse vija e ujitjes mund të jetë vetëm si barrë reale për të paditurin apo e drejtë reale e paditësve mbi patundshmërinë e të paditurit, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësit janë edhe pronarë të saj.

Nga të lartcekurat, rezulton se nuk ekziston asnjë bazë ligjore mbi të cilën paditësit do të mund të kishin fituar të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë kontestuese, pasi që për t'u fituar e drejta e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, duhet të plotësohen kushtet ligjore dhe se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar se në rastin e paditësve nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara sipas dispozitave ligjore, për fitimin e një të drejte të tillë nga ana e paditësve.

Sa i përket pretendimit së gjykata e shkallës së parë i ka dëgjuar dëshmitarët M.D. dhe I.L., por që nuk ka dhënë asnjë fjalë së a ja fali besimin apo jo, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim nuk qëndron pasi që gjykata ka konstatuar së ja ka falur në tërësi besimin duke qenë së ishte në përputhje me gjendjen faktike të cilën gjykata e ka konstatuar me rastin e daljes në vendshiqim dhe në përputhje me provat e tjera nga shkresat e lëndës. Ndërsa sa i përket pretendimit së gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitarët M.D. dhe F.P., por se nuk i ka përmendur në arsyetim, kolegji, vlerëson së mos elaborimi i deklaratave të këtyre dëshmitarëve në arsyetim të aktgjykimit, nuk ka pasur ndikim në ligjshmërinë e aktgjykimit, pasi që me deklarinimin e këtyre dëshmitarëve të cilët janë familjar të palëve ndërgjyqëse nuk mund të vërtetohet një gjendje tjetër faktike siç është konstatuar nga gjykata e shkallës së parë. Edhe sa i përket pretendimit së gjykata e shkallës së parë nuk e ka përmendur shënimin zyrtar të Policisë së Kosovës nr.7237, i datës 19.10.2016, Gjykata e Apelit, vlerëson së edhe kjo provë nuk ka ndikim në ndryshimin e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë me provat e nxjerra në procedurë siç është dëgjimi i dëshmitarëve dhe palëve ndërgjyqëse dhe këqyrja në vend së bashku me ekspertin e gjeodezisë, duke marrë parasysh faktin së në këtë shqyrtim gjyqësor nuk është propozuar që të dëgjohet zyrtari që e ka përpiluar këtë raport.

Lidhur me pretendimin ankimor sa i përket shkeljes së dispozitës së nenit 362 të LPK-së, me të cilën është paraparë obligimi i gjykatës që të ftojë në seancën ekspertët e angazhuar, Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pabazuar, ngase në rastin konkret fakti i mos ftesës së ekspertit në seancë nuk paraqet shkelje e cila do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, për faktin se pala paditëse pas pranimit të ekspertizës së ekspertit, të njëjtit nuk kanë paraqitur ndonjë vërejtje apo kundërshtim të ekspertizës dhe nuk kanë kërkuar që eksperti të ftohet për sqarim, meqë ekspertiza ka përcaktuar kufijtë kadastral në mes të palëve ndërgjyqëse dhe matjen e pjesës përtej kufirit kadastral në brendi të ngastrave të të paditurit, konform

pretendimeve të palës paditëse, dhe bazuar në këtë konstatim paditësit edhe e kanë precizuar kërkesëpadinë.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2413/2021, datë 11.09.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci